

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PKL- KZZ- 137/2011
13 prill 2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga z. Francesco Florit si Kryetar i kolegjit dhe nga znj. Marije Ademi, znj. Nesrin Lushta, z. Salih Toplica z. Martti Harsia si anëtarë të kolegjit, të asistuar nga Këshilltari ligjor z. Adnan Isufi si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të pandehurit:

A.B

[REDAKTOHET] [REDAKTOHET] [REDAKTOHET] [REDAKTOHET] [REDAKTOHET]
[REDAKTOHET] [REDAKTOHET] [REDAKTOHET] [REDAKTOHET] [REDAKTOHET]
[REDAKTOHET] [REDAKTOHET] [REDAKTOHET] [REDAKTOHET] [REDAKTOHET]

I dënuar për kryerjen e veprës penale të Dhunimit, në kundërshtim me Nenin 193, par. 3, nënpar. 3, lidhur me par. 2, nënpar. 1 dhe 2 të KPK-së dhe për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 328, par. 2 të Kodit Penal të Kosovës (më tutje "KPK"),

Duke vendosur rreth Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të shtetit të Kosovës (më tutje "Prokurorit"), ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P. Nr. 461 / 2006 - P 497 / 2006, të datës 27 tetor 2006, ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap - Kz 127 / 2007, të datës 27 dhjetor 2007, në dobi të të dënuarit Agron Bytyqi,

Në bazë të Nenit 454, par. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (më tutje "KPPK"), pas seancës së këshillimit dhe votimit të mbajtur më 13 prill 2012, Gjykata Supreme e Kosovës nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P nr. 461 / 2006 - P 497 / 2006, e datës 27 dhjetor 2006 dhe ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz 12/2007, e datës 27 dhjetor 2007 dhe vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap-Kz 12/2007, e datës 27 dhjetor 2007 në bazë të Nenit 456 të KPPK-së.

A R S Y E T I M

I. Historia e procedurës

Më 5 qershor 2006, Prokurori publik i qarkut ka ngritur Aktakuzën ndaj të pandehurve [REDAKTOHET], [REDAKTOHET] dhe [REDAKTOHET]. I pandehuri [REDAKTOHET] është akuzuar për veprën penale të Dhunimit, në kundërshtim me Nenin 193 (2), pikën 3 të KPK-së dhe për Kanosje sipas Nenit 161 (2) të KPK-së. Ndërsa i pandehuri [REDAKTOHET] është akuzuar

C.A., X.D., B.H., E.S., **X. D.**

për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 328, par. 2 të Kodit Penal të Kosovës. Të tre të pandehurit sipas kësaj aktakuze janë akuzuar edhe për kryerjen e veprës penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare sipas Nenit 316 (3) të KPK-së.

Më 13 qershor 2006, Prokurori publik i qarkut ka vendosur të zgjerojë hetimet ndaj të A .B . pandehurit [REDACTED] për kryerjen e pretenduar të dhunimit ndaj palës së dëmtuar A .A . duke e kanosur të njëjtën me revole.

Më 15 qershor 2006, Prokurori publik i qarkut ka ngritur aktakuzës ndaj të pandehurit [REDACTED] A .B . PP 333 – 4 / 2006) për veprën e pretenduar penale të Dhunimit, në kundërshtim me Nenin 193 (2), paragrafin 3, nënpar. 3, lidhur me par. 2 dhe nënpar. 1 dhe 2 të KPK-së; dhe për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 328, par. 2 të Kodit Penal të Kosovës. Të njëjtën ditë, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka bërë kërkesë për bashkimin e procedurës penale ndaj [REDACTED] me procedurën ndaj tre të pandehurve të mëhershëm. Të dy aktakuzat janë konfirmuar në mënyrë të ndarë nga gjykata, edhe pse më vonë u bashkuan të dy këto procedura penale.

Më 27 tetor 2006, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (P 461 / 2006 dhe P 497/2006) ka shpallur A .B . fajtor të pandehurit [REDACTED] për veprën penale të Dhunimit (Neni 193 (3), pika 3 dhe për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 328, par. 2 të Kodit Penal të Kosovës. Po ashtu të pandehurit e tjerë janë dënuar për krimet e përmendura në akuzat ndaj tyre [REDACTED] megjithatë është liruar nga akuza e dhunimit.

E .S .

Gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar ndaj të pandehurit [REDACTED], dënimin unik prej gjithsej tre (3) vjetësh burgim, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim.

Më 27 dhjetor 2007, Gjykata Supreme e Kosovës ka refuzuar ankesën e ushtruar në emër të të pandehurit Agron Byqtqi dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

A .B .

Më 24 korrik 2009, i pandehurit [REDACTED] përmes avokatit të vet mbrojtës ka bërë kërkesë për rihapjen e procedurës penale pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Kjo kërkesë është refuzuar si e pabazë nga gjykata.

Më 6 korrik 2011, Prokurori ka bërë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës. Kjo kërkesë e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, e datës 27 tetor 2006 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 27 dhjetor 2007 ka qenë ekskluzivisht në dobi të të pandehurit [REDACTED]

A .B .

II. Procedura në Gjykatën Supreme të Kosovës

Më 14 mars 2012, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës ka kërkuar nga Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it që lëndën në fjalë ta marrin Gjyqtarët e EULEX-it.

Më 19 mars 2012, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it sipas nenit 3.6 të Ligjit mbi kompetencat, ka kërkuar nga palët në procedurë që t'i dorëzojnë mendimet e tyre lidhur me çështjen duke theksuar se kushdo që nuk jep komente brenda një javë nga momenti i pranimit të këtij urdhri do të konsiderohet se i bashkohet kërkesës.

Më 29 mars 2012, pas shqyrtimit të mendimeve të dorëzuara, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka vendosur ta marrë lëndën në kompetenca dhe përgjegjësi të gjyqtarëve të EULEX-it për të vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Vendimi për marrjen e lëndës i është dërguar palëve në të njëjtën ditë.

III. Çështja

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon në shkelje substanciale të dispozitave të kodit të procedurës penale sipas leximit të kombinuar të nenit 451 (1), pikave 2 dhe 3, nenit 451 (3), nenit 403 (1), pikës 8 dhe nenit 403 (2) të KPPK-së, në lidhje me nenin 387 (1) dhe (2) dhe nenin 396 (7) të KPPK-së, dhe nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 (PNDCP) dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ) si instrument për interpretim sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës.

A .6 . Prokurori pohon se gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata nuk ka vlerësuar provat relevante në dobi të të pandehurit [REDACTED] dhe prandaj vlerësimi i gjykatës është bazuar në prova të cilat nuk i përbushin standarde e fajësisë "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm" i cili është i nevojshëm për një dënim.

A .6 . Prokurori gjithashtu pohon se nuk ka prova të mjaftueshme për ta bazuar fajësinë e të pandehurit [REDACTED] për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve (referencë nenit 403 (1) pika 8 e KPPK-së).

Dështimet e përshkruara, është qëndrim i Prokurorit, përbëjnë shkelje të rregullit i cili duhet të udhëheq gjyqtarin në vlerësimin e provave, duke e obliguar gjyqtarin që të vlerësoj në mënyrë të ndërgjegjshme secilën prova [REDACTED] dhe në lidhje me provat e tjera në dispozicion (neni 387.1 KPPK-së). Prandaj, argumenti është, ato janë gabime në ligj. Vlerësimi i gabuar i gjendjes faktike është vetëm pasojë e aplikimit të gabuar të rregullave për nxjerrjen e aktgjykimit.

A .6 . Duke mos respektuar rregullin e përmendur, pretendohet se, gjykata ka marrë një aktgjykim dënuarit [REDACTED] nga të gjitha akuzat (neni 457 (1) i KPPK-së) ose të anulohen pjesërisht aktgjykimet e kundërshtuara të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (P 461-497/2006) dhe i Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap-Kz 127/2007), ose vetëm aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe lënda të kthehet për rivendosje ose rigjykim në gjykatën e shkallës së parë ose në gjykatë më të lartë (neni 457 (2) i KPPK-së).

IV. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e lejueshme. Kërkesa është paraqitur nga personi i autorizuar dhe pranë gjykatës kompetente sipas nenit 454 paragrafit 1.

Interpretimi i zakonshëm i dispozitës së nenit 454 të KPPK-së i mundëson Prokurorit që të paraqes kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë pa asnjë afat kohor. Prandaj, gjithashtu në këtë lëndë, ku vendimi është bërë i formës së prerë para disa viteve, kërkesa është e lejueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në seancë siç është përcaktuar me nenin 454 paragrafin 1 të KPPK-së. Njoftimi i palëve për këtë seancë nuk ka qenë i obligueshëm.

Në aktgjykimet e kundërshtuara, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur asnjë gabim procedural, i cili duhet të merret në konsideratë sipas detyrës zyrtare. Prandaj, sipas nenit 455 të KPPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës do të kufizohet në ekzaminimin e atyre shkeljeve të ligjit të cilat pala kërkuese i pretendon në kërkesë.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata gjen se Prokurori nuk pretendon në vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Prokurori në mënyrë eksplikite tregon se kërkesa nuk është bazuar mbi bazën e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Si rezultat, gjykata do të përbahet nga vlerësimi i kësaj pike.

Përveç kësaj, është e rëndësishme të nënvízohet se nuk ka hapësirë në këtë lëndë për një vendim të Gjykatës Supreme në kushtet e parapara të nenit 458 të KPPK-së, pasi që nuk e kemi situatën e "dyshimit të konsiderueshëm" (standardi i përcaktuar me ligj) sa i përket saktësisë së vërtetimit faktik, siç do të kërkohej për anulimin e vendimit dhe urdhërimin e një gjykimi të ri. Në të vërtetë, ajo që pretendohet nga Prokurori i njëjtë është pamjaftueshmëria e provave (nuk janë të mjaftueshme për ta përashtuar dyshimin e arsyeshëm lidhur me fajësinë e të pandehurit) dhe jo mungesa apo keqinterpretimi i provave në dispozicion. 'Dyshimi i konsiderueshëm' është një pasiguri më e rëndësishme dhe më substanciale se 'dyshimi i arsyeshëm'. Prania e dyshimit të tillë kritik dhe deri në atë masë në këtë lëndë madje nuk pretendohet nga Prokurori dhe nuk ka indikacione që do ta nxisin Gjykatën Supreme për t'i ri-ekzaminuar të gjitha provat sipas detyrës zyrtare.

Më tutje, Prokurori nuk pretendon në papranueshmërinë e ndonjë prove të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Sic është thënë, Prokurori pretendon në pamjaftueshmërinë e provave të nevojshme për dënimin përfundimtar të të pandehurit. Prokurori pohon se gjykatat e të dy shkallëve nuk i janë përbajtur standardit "përtëj çdo dyshimi të bazuar" të provave i cili patjetër duhet të përbushet për ta dënuar një të akuzuar në një procedurë penale. Prokurori posaçërisht parashtron se "nëse dëshmia e një viktima të pretenduar të dhunimit para gjykatës nuk vërtetohet me ndonjë provë tjetër (me përashtim të provave të thashethemeve nga ndonjë dëshmitare tjetër - [redacted] ka qenë i mjaftueshëm "përtëj çdo dyshimi të arsyeshëm" për dënimin e të pandehur [redacted] posaçërisht kur viktima nuk ka pohuar se është kryer ndonjë krim kundër saj nga [redacted] në fazën e hershme të hetimeve (deklaratat e polisë të mbledhura në maj 2006) dhe pretendimet e saj kundër të njëjtit

A . B . A . B .

A . b .

- kanë evoluar dhe shtuar me kalimin e kohës". Përveç kësaj, Prokurori pyet nëse "mungesa e ndonjë ekzaminimi mjekësor apo raporteve në lidhje me dhunimin e pretenduar të [REDACTED] mungesa e ndonjë prove fizike apo të ndonjë prove tjetër substanciale vërtetuese në lidhje me dhunimin e pretenduar dhe krimave të tjera për të cilat [REDACTED] është dënuar, fakti se asnjë polic nuk ishte intervistuar lidhur me dhunimin që kinse e kishte pësuar [REDACTED] (dhe si dhe nëse kishin njohuri për këtë), mungesa e përpjekjes që gjykata të mundohet ta vërtetojë se a ishte [REDACTED] e Shqipëri në kohën kur dhunimi pretendohet se ishte kryer, ishin elemente që nuk duhej të merreshin parasysh në dënimin e [REDACTED]. A . b .
- A . A . pësuar [REDACTED] (dhe si dhe nëse kishin njohuri për këtë), mungesa e përpjekjes që gjykata të mundohet ta vërtetojë se a ishte [REDACTED] e Shqipëri në kohën kur dhunimi pretendohet se ishte kryer, ishin elemente që nuk duhej të merreshin parasysh në dënimin e [REDACTED]. A . b .
- A . b . [REDACTED]

Gjykata Supreme së pari vëren se standardi 'përtej çdo dyshimi të arsyeshëm' është, në kontekst të legjislacionit të Kosovës, një plotësim i cili vjen prej një tradite tjetër ligjore. Natyrisht se nuk kontestohet vlefshmëria e standardit i cili paraqet një parametër themelor për caktimin e fajësisë në sistemin ligjor anglosakson si dhe gjökundi (ky parim ka hyrë në Kodin e Procedurës Penale të Italisë, neni 533.1, në 2006 me statut 20 shkurt 2006, n.46 – rasti i parë në familjen e sistemeve ligjore civile), por duhet të shënohet se Prokurori plotëson dhe motivon tërë propozimin e tij duke argumentuar në bazë të standardit ('përtej çdo dyshimi të arsyeshëm') të cilin ai e konsideron si të nënkuftueshme por kjo nuk mund të gjendet në instrumente ligjore të cilat ai i citon. Prandaj, pse të përmendet diçka që nuk është standard ligjor në Kosovë, vetëm pse është një shprehje e zakonshme ligjore e cila është bërë e njohur në zhargonin juridik por jo edhe në sistemin ligjor të Kosovës? A nuk mjafton të thuhet se, për të marrë një vendim për dënim, i pandehuri duhet të shpallet fajtor, pa shitesën 'përtej çdo dyshimi të arsyeshëm'?

Pohimi se një parim është i nënkuftueshëm në KEDNJ nuk është i drejtë: citat nga komentimet mbi Ligjin e Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut (Harry, O'Boyle dhe Warbrick – Oxford, 2009), faqe.302: 'Sa i përket standardit të provave, nuk ka formulim të quartë se provimi i fajësisë kërkohet përtej dyshimit të arsyeshëm; në lëndën Austria kundër Italisë (6YB740 at 784 (1963) Com Rep; CM Res DH (63)3) Komisioni pohon se Neni 6(2) kërkon që gjykata të shpallë të akuzuarin fajtor vetëm në bazë të provave 'mjaftueshëm të fuqishme sipas ligjit për ta vërtetuar fajësinë'.

Njësoj vlen edhe për nenin 14 të PNDCP-së (Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike), ku formulimi është i ngjashëm me nenin 6 ECHR, d.m.th. 'të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia të provohet në përputhje me ligjin'.

Duke i adresuar këto çështje përkitazi me lëndën specifike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon se, për një procesit të rregullt ligjor, një person i akuzuar për vepër penale, mund të shpallet fajtor vetëm pasi prokuroria t'i ketë provuar të gjitha elementet e veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit në procedurë ligjore penale të zhvilluar nga gjykata kompetente. Gjykata vepron në përfundim me rregullat ligjore që garantojnë se asnjë person i pafajshëm nuk do të dënohet, ndërsa fajtorit t'i shqiptohet dënim ose sanksion tjetër penal sipas kushteve të parapara me ligjet në bazë të të cilave janë paraparë veprat penale sipas procedurës së zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, pas vlerësimit me kujdes të provave.

Sa i përket lëndës në fjalë, gjykata e shkallës së parë konsideron se në muajin gusht ose shtator të vitit 2005 rreth orës 22:00, i pandehuri me anë të kërcënimit qëllimisht e ka

A . A . shtyrë viktimin [REDACTED] të kryejë akte seksuale me të duke e marrë atë me veturën Audi 80, në lagjen Vranjevc në Prishtinë, ku ka nxjerrë revolen e tij, që e mbante pa leje të vlefshme, e ka detyruar atë të qëndrojë brenda veturës, dhe i ka thënë asaj: "sonte do të bësh gjithçka që unë të them të bësh, përndryshe je e vdekur", gjersa kur viktima u mundua ta kapë telefonin e saj mobil për ta thirrur të akuzuarin [REDACTED] i akuzuari [REDACTED] E . S .

A . B . [REDACTED]uk e lejoi atë dhe nisi veturën drejt liqenit të Batllavës, pastaj u ndal në pyll, e nxori revolen e tij, ia drejtoi viktimës në kokë dhe i tha: "zhvishi rrobot ose të vrava por nuk do të vras menjëherë, por do të plagos dhe të lë të derdhësh gjak këtu në mal me ujq derisa të çmendesh", pastaj ajoq hoqi pantallonat e saj, të brendshmet, e pastaj ai e uli karrigen e pasagjerit, hipi mbi të dhe bëri seks me të dy herë.

A . A .

Gjykata konstatoi se dëshmja e palës së dëmtuar [REDACTED] lidhur me veprën penale për të cilën i akuzuari [REDACTED] u shpall fajtor, ishte bindëse, e singertë dhe objektive dhe dëshmisë së tillë të dëshmitares gjykata ia dha besimin e plotë. Deklarata e palës së dëmtuar u vërtetua me dëshminë e dëshmitares [REDACTED] e cila dëshmoi se pala e dëmtuar vetë i kishte treguar në telefon dhe sy më sy se i akuzuari [REDACTED] e kishte dhunuar atë.

M . A .

A . B .

Argumentim i dënimit mbi këto elemente është i mjaftueshëm, me kusht që të ketë motivim të mjaftueshëm dhe jo-kontradiktor.

Argumentet e përdorura nga Prokurori me qëllim që të tregojnë se prova nuk është e mjaftueshme, janë kontradiktore, jo vendimtare dhe jo bindëse.

Ekziston kontradiktë, sepse kur Prokurori pyet në mënyrë retorike *nëse deklarata e një viktime të pretenduar të dhunimit para një gjykate, që nuk konfirmohet me asnjë provë tjetër (me përashtim të provave thashetheme nga një tjetër dëshmitar- [REDACTED] është e mjaftueshme, ai nuk ka parasysh atë, në të kundërtën, deklarata e viktimës në të vërtetë ishte konfirmuar (deklarata e [REDACTED] është thashetheme në lidhje me [REDACTED] pëershkrimin e dhunimit, por ajo është një konfirmim direkt se viktima e ka lajmëruar për dhunimin shoqen e saj në një kohë që nuk dyshohej).*

M . A .

M . A .

Argumentet janë të diskutueshme dhe jo bindëse, sepse kur është fjala për një dhunim të kryer me modalitetet e përshkruara, është e pakuptimitë të pritet të gjendet ndonjë gjurmë e dhunës fizike (nuk ka pasur dhunë fizike, zonjusha u dorëzua prej kërcënimit).

E njëjtë gjë vlen edhe për modalitetet dhe kohën në të cilën është bërë denoncimi (një vit pas kryerjes së dhunimit): është absolutisht normale që viktima e një dhunimi gjen guximin për të denoncuar sulmuesin atëherë kur rreziku i hakmarrjes (njësoj me [REDACTED], në rastin aktual) kalon.

A . A .

Të gjitha argumentet e përdorura nga Prokurori në përpjekje për të diskredituar depozitimin e [REDACTED] nuk arrijnë në më shumë se formulimin gjenerik që lehtë mund të

A . A .

A .b . kundërshtohet: fakti se depozitimi dhe numri i detajeve të dhunimit shtohen me kohën, fakti që [REDACTED] ishte hetuar vetëm në fund të hetimit kryesor kundër [REDACTED] dhe shokëve të tij, dhe kështu me radhë, janë karakteristika që janë të përbashkëta në shumë hetime dhe që zakonisht nuk kanë një rëndësi të veçantë në vlerësimin e dëshmisë. Përkundrazi, ato mund të merren si tregues të kredibilitetit të dëshmitarit e cila do të kishte vepruar më me shkathtësi, po që se do të kishte qëllim që ta denonconte rrejshëm [REDACTED] S.

Diskutimi që pason, mbi provat e paraqitura gjatë gjykimit dhe mbi mjaftueshmërinë e tij për të bazuar vendimin e fajësisë të të pandehurit, vë në dukje një dobësi tjetër të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të ngritur nga Prokurori.

Në të vërtetë, Prokurori ka paraqitur ankesë (nuk lejohet në këtë lëndë) shtesë dhe jo mbrojtje të ligjshmërisë.

Po që se, po ashtu, poohet shkelja e rregullës së aktgjykimit, Prokuroria në të vërtetë ka kontestuar rezultatin e zbatimit të rregullave të përmendura dhe kështu praktikisht ka kërkuar vlerësimin (të tretë) e më tejmë të provave në dispozicion.

Mbrojtja e ligjshmërisë duhet të ketë qëllimin të korrigojë një gabim në interpretimin dhe zbatimin e ligjit dhe jo një gabim të supozuar në interpretimin e fakteve.

Për të konfirmuar se kërkesa ishte e bazuar në një paragjykim të thjeshtë, më shumë sesa në një urgjencë të restaurimit të ligjshmërisë, është me rëndësi të konsiderohet se vetë kërkesa nuk merr barrën të tregoj ndonjë fragment të aktvendimit të kundërshtuar i cili është supozuar si i metë ose kontradiktor për të mos ekspozuar ndonjë pamjaftueshmëri të motivimit apo për të cituar ndonjë fragment ku motivimi mund të ishte i mangët. Mbi këtë bazë, pothim i Prokurorit që prova është e pamjaftueshme për të bazuar dënimin është thjesht një aksiom tautologjike.

IV. Konkluzioni i Gjykatës Supreme të Kosovës

Në kuadër të kësaj që u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës nxjerr përfundimin:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga kerkuesi, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P nr. 461/2006-P 497/2006, të datës 27 tetor 2006 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap-Kz 127/2007, të datës 27 dhjetor 2007, është e pabazuar.

Në kuadër të kësaj që u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PKL-KZZ 137/2011, data 13 prill 2012

Kryetari i kolegjit:

Francesco Florit

Procesmbajtësi:

Adnan Isufi

Gjyqtar i EULEX-it

Këshilltar Ligjor i EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

Nesrin Lushta

Salih Toplica

Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Marije Ademi

Martti Harsia

Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Gjyqtar i EULEX-it